



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 37

Prishtinë, më 22.2.2019, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Besa Gaxherri, Ganimete Musliu, Andin Hoti, Salih Zyba, Salih Salihu dhe Etem Arifi.

Munguan : Liburn Aliu, Sërgjan Mitroviq, Lutfi Zharku dhe Danush Ademi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Muharrem Nitaj**, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të komisionit nga mbledhja e mbajtur më 12.2.2019;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për pijet e forta alkoolike;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-247;
5. Formimi i grupeve të punës për projektligjet, që kanë kaluar leximin e parë;
6. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës, e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari, propozoi që të shtohet si pikë e rendit të ditës, *Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për Rregullimin e shërbimeve të ujit*, pasi që e kanë shqyrtuar komisionet e përhershme dhe të procedohet për lexim të dytë.

Rendi i ditës nga komisioni u anashkalua sa i përket pikës 2, duke obliguar stafin që të hartojë procesverbalin e datës 12.2.2019.

Para shqyrtimit të pikave të mbetura të rendit të ditës, u zhvillua një debat për çështjet si në vijim:

Salih Zyba, u angazhua për prezantimin e udhëheqjes së Ministrisë së Bujqësisë në mbledhjet e komisioneve, prandaj në mungesë të realizimit të aktiviteteve të duhura në komision, propozoi shtyrjen e kësaj mbledhjeje, ngase premtimi i kryetarit ka qenë për këtë mbledhje të sigurohet prania e zyrtarëve të MB-së.

Kryetari, nuk e pa të arsyeshme shtyrjen e mbledhjes ngase disa projektligje në komision janë grumbulluar dhe presin aktivitetet e duhura, kurse rreth vërejtjeve për procesverbalin e mangët, kërkoi sqarim. Ai u njoftua se mungesat e stafit rrallë ndodhin, por pasi kanë munguar dy zyrtarët, më 12 shkurt dhe stafi që i ka zëvendësuar, ka incizuar dhe ka bërë disa shënime të shkurta, ato do të shfrytëzohen dhe do të hartohet ky proces për mbledhjen e radhës.

Besa Gaxherri, në lidhje me Ministrinë e Bujqësisë, veçoi siç tha ajo, veprimet destruktive të ministrit të shkarkuar dhe komisioni as që ka mundur të pres diçka më mirë deri më tani, kurse mosardhjen e zëvendësministrit, nuk e arsyetoi ngase të gjithë zyrtarët e MB-së duhet të dinë se ky organ (komisioni) i kontrollon ata, përkatësisht e kontrollon punën e tyre, prandaj është e patolerueshme që kjo ministri të mbetet jashtë kontrollit parlamentar.

Në vazhdim pasuan diskutimet dhe polemikat, rreth asaj se si të përfundohet me çështjen e përfaqësimit të MB-së në komision:

Andin Hoti, propozoi që në lidhje me grantet të ftohet kryeshefi i Agjencisë së Zhvillimit të bujqësisë pasi që ai është kompetent për këtë.

Pse stafi nuk i ka dërguar përgjigjet me shkrim nga MB-ja, presim përgjigje nga kryetari për mbledhjen e radhës (**Besa Gaxherri**), ndërsa **stafi** sqaroi se mbledhjet ndonjëherë caktohen dy ditë para mbajtjes, kurse sipas rregullores, duhet së paku 4 ditë përpara.

Salih Zyba, refuzoi propozimin që rreth problemit të granteve të ftohet kryeshefi i AZHB-së, por përfaqësuesi, përkatësisht ministri i MB, ndërsa **kryetari** theksoi se nuk pati mandat të obligojë zyrtarët e MB-së, që të prezantojnë, pasi ata theksonin se Qeveria e mandaton përfaqësuesin, në rast të shkarkimit të ministrit.

Ganimete Musliu, tha se nuk është vetëm një zëvendës në këtë ministri, por ka edhe tjerë, të cilët mund t'i ftojë, kurse **Salih Salihu**, tha se kryetari duhet ti drejtohet kryeministrit dhe të ftohet një zyrtar dhe të dihet se ku ka përfunduar shkresa e dërguar nga kryetari dhe për këto punë tha se do të angazhohet kryetari.

Nuk është kjo çështje vetëm teknike (**Salih Zyba**), por edhe politike, ngase kemi skandale të njëpasnjëshme dhe insistoj të votohet për mbajtjen apo jo të mbledhjes së sotme.

Në fund të diskutimeve, kryetari e hodhi në votim propozimin e deputetit Salih Zyba, për ta shtyrë këtë mbledhje por nuk i mori votat e mjaftueshme, ndërkaq Salih Zyba braktisi mbledhjen. Ndërsa për rendin e ditës me ndryshimin e propozuar, votuan 6 deputet për.

2. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për Rregullimin e shërbimeve të ujit

Kryetari, i njoftoi anëtarët e Komisionit se Komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar raportin plotësues dhe kanë dërguar raportet me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për Rregullimin e shërbimeve të ujit dhe të procedohet për lexim të dytë.

Ai ftoi anëtarët e komisionit për votim dhe pas votimit konstatoi se komisioni me 6 vota për, asnjë kundër dhe abstenim, vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë:

Raport me rekomandime

për Projektligjin nr. 06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për Rregullimin e shërbimeve të ujit

3. Shqyrtimi i Projektligjit për pijet e forta alkoolike

Kryetari, paraqiti për shqyrtim në parim Projektligjin dhe tha se Projektligji ka për qëllim krijimin e kornizës ligjore për parimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me regjistrimin, prodhimin, përpunimin, treguesit gjeografikë të mbrojtur, kualitetit, përshkrimin, prezantimin dhe etiketimin, importimin, tregtimin e brendshëm dhe eksportimin e pijeve të forta alkoolike në Republikën e Kosovës.

Pasi që nuk kishte diskutues, ai ftoi anëtarët e komisionit për votim dhe konstatoi se komisioni me 6 vota për, asnjë kundër dhe abstenim, vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji për pijet e forta alkoolike

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-247;

Kryetari, paraqiti për shqyrtim në parim Projektligjin dhe shtoi se arsyeja që Qeveria e ka sjellë këtë projektligj është se afati për aplikim për privatizimin e banesave sipas këtij ligji ka skaduar me datë 27 mars 2015, mirëpo gjendja aktuale e shitjes së banesave për të cilat ekziston e drejta banesore ende është e papërfunduar. Prandaj propozohet që të zgjatet afati për shitjen e këtyre banesave dhe të përfundoj ky proces mbrenda tre (3) viteve, përkatësishtë deri në vitin 2021. ndërkaq **Andin Hoti** kërkoi sqarim rreth projektligjit për të cilin kryetari sqaroi se bëhet fjalë për shtyerje të afatit edhe për tre vite për ata që nuk kanë pasur mundësi regjistrimi kurse gëzojnë drejtën banesore.

Pasi që nuk kishte diskutues, ai ftoi anëtarët e komisionit për votim dhe konstatoi se komisioni me 6 vota për, asnjë kundër dhe abstenim, vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-153 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-247

5. Formimi i grupeve të punës për projektligjet, që kanë kaluar leximin e parë;

Kryetari, i ftoi anëtarët e komisionit që të formojnë grupet punuese për ato projektligje të cilat presin të shqyrtohen:

Për **Projektligjin për mbrojtjen e ajrit nga ndotja**, u konfirmua se grupi punues është i tërë komisioni. Fillimisht do të kryhet vizita në Kroaci me homologët e atjeshëm, pastaj komisioni do të vazhdojë me amendamente eventuale. Pastaj u formuan 3 Grupe të punës:

1. Grupi i punës për Projektligjin për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës, në këtë përbërje: Muharrem Nitaj -kryesues, Besa Gaxherri dhe Salih Zyba, anëtarë;
2. Grupi i punës për Projektligjin për për produktet biocide, në këtë përbërje: Salih Salihu - kryesues, Ganimete Musliu dhe Lutfi Zharku, anëtarë;
3. Grupi i punës për Projektligjin për Odën e Arkitektëve dhe Odën e Inxhinierëve në fushën e ndërtimit, në këtë përbërje: Liburn Aliu -kryesues, Etem Arifi dhe Danush Ademi anëtarë;

Për shkak të mungesës së disa anëtarëve, mund të ketë ndryshime në përbërjen e grupeve punuese dhe kjo do të konfirmohet deri në mbledhjen e radhës.

6. Të ndryshme.

Komisioni u pajtua :

- Komisioni shqyrtoi kërkesën e NPN “HOXHA” për interpretim të dispozitës ligjore të Ligjit për ndërtim, drejtuar Komisionit dhe konstatoi se: Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, vlerësoi se nuk është në fushëveprimtarinë e tij interpretimi i legjislacionit në fuqi dhe nenet përkatëse të Ligjit për ndërtim.
- Rreth Projektligjit për farëra, i cili është në strategjinë legjislative të Qeverisë për këtë vit, të hartohet në fund të vitit, të dërgohet shkresa për MB-në rreth mundësisë që të hartohet menjëherë për shkak të rëndësisë së madhe për mbjelljet pranverore.
- Vizita studimore e komisionit në Kroaci për Projektligjin e ajrit, është propozuar të kryhet në pjesën e parë të muajit mars, përkatësisht prej 3 deri më 6 mars, mirëpo, kjo varet nga konfirmimi i nikoqirit, për çka komisioni do të njoftohet me kohë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Muharrem Nitaj